



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



P R O C E S V E R B A L

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), e mbajtur më 20.5.2024, me fillim në orën 10:10. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit, **Arbër Zenuni**.

Kryesuesi: Fillimi, përshtendetje për të gjithë! Përshtendetje nënkyetar **Fatmir Iska**. Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtive, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, të gjithë ju të pranishëm! E hapim mbledhjen e pestë (5) të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2024. Në konsultim me kryetarin e Komunës, kemi përgatitur këtë:

R E N D D I T E

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e vendimit për shpalljen "QYTETAR NDERI" të Komunës së Rahovecit, z. Pandeli Majko, ish-kryeministër i Republikës së Shqipërisë;**
- 3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, personave fizikë dhe juridikë nga 1 (një), deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, P- 01039-0, Z.K. Xërxe;**
- 4. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P- 01039-0, Z.K. Xërxe;**
- 5. Shqyrtimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 8/2013, të datës 2.4.2013, për konstituimin e të drejtës së servitutit sendor në pronësinë komunale.**
- 6. Shqyrtimi i vendimit për miratimin e të drejtës së kalimit në parcelën publike komunale me nr. 71510032-00069-0, Z.K. Zoqisht;**
- 7. Të ndryshme.**

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë të KPF-së, a kemi ndonjë pikë tjetër shtesë, apo diskutim? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim! Kush është "për"?... kundër?... Konstatoj që me shumicë votash (5 vota "për"), votohet rendi i ditës për sot.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: A ka dikush ndonjë vërejtje rreth procesverbalit? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim! Kush është "për"?... Konstatoj që unanimisht votohet pika e parë e rendit të ditës.

2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e vendimit për shpalljen "QYTETAR NDERI" të Komunës së Rahovecit, z. Pandeli Majko, ish-kryeministër i Republikës së Shqipërisë:

Nënkyetari: Faleminderit, kryesues! Të nderuar anëtarë të KPF-së, përfaqësues të KFOR-it, drejtorë, të pranishëm. Para vetes e keni propozimin për shpallje "Qytetar Nderi" për ish-kryeministrin e Shqipërisë, z. Pandeli Majko. Është kërkesë nga radhët e Organizatës së Veteranëve të Luftës. Në propozim-vendim e keni arsyetimin dhe kërkojmë nga ju miratimin, si dhe në seancë të Kuvendit do të diskutojmë. Unë si Fatmir dhe nënkyetar, jam shumë dakord me këtë propozim, për kontributin e tij, veçanërisht sa ishte kryeministër, kontribuoi në momentet më të vështira gjatë luftës në Kosovë.

Burim Krasniqi: Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për ekzekutivin, kolegë të KPF-së, KFOR-in! Çështja e shpalljes “Qytetar Nderi” a do të jetë pjesë e vazhdimesisë së të njëjtës seancë? Nëse është pjesë e të njëjtës seancë, më duket e zbehtë për një kryeministër.

Nënkyetari: Realisht duhet të kalojë për procedura në Kuvend, por më datë 14 qershor, me datën e çlirimit, ne do të kemi seancë solemne dhe aty do ta miratojmë këtë akt të shpalljes “Qytetar Nderi” të ish-kryministrit Pandeli Majko.

Kryesuesi: Faleminderit, nënkyetar! Nëse nuk kemi diskutime të tjera, e kalojmë në votim. Kush është “për”?... Konstatoj që unanimisht votohet pika e dytë.

3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, personave fizikë dhe juridikë nga 1 (një), deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, P- 01039-0, Z.K. Xërxe:

Afrim Oruqi: Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkyetar, kolegë drejtorë, të nderuar anëtarë të KPF-së. Bazuar në ligjet e aplikueshme, kryetari i Komunës ju propozon që të merrni vendim për dhënien në shfrytëzim për 15 vjet, P-01039-0, Z.K. Xërxe, prej pjesës së përgjithshme të japim me qira vetëm 950m².

Defrim Kafexhiu: Përshëndetje për të gjithë! Faleminderit kryesues! Një pyetje e kam për drejtorin rrëth kësaj pike. Meqenëse, për t'u dhënë janë vetëm 950m² dhe specifikisht dihet se ku është, kujt do t'i jepet dhe cili është destinimi i parcelës?

Afrim Oruqi: Në pyetjen e kuvendarit në lidhje me parcelën: parcela gjendet në Z.K. Xërxe, te depot e matreksit. Aty janë duke operuar suksesshëm disa biznese dhe gjithashu ka disa kërkesa për parcelën në fjalë. Pas marrjes së vendimit, do të zhvillohen procedurat e tjera të ankandit publik. Kush jep më shumë e fiton pjesën e parcelës.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! A keni ndonjë diskutim tjeter? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim! Kush është “për”?... kundër?... Me shumicë votash (4 vota pro), aprovohet pika e tretë.

4. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P- 01039-0, Z.K. Xërxe:

Afrim Oruqi: Bëhet fjalë për formimin e komisionit i cili do t'i zhvillojë procedurat për parcelën e njëjtë, në vendin dhe në sipërfaqen e njëjtë. Komisioni do t'i ketë 5 anëtarë: dy nga ekzekutivi, dy nga Kuvendi dhe një nga shoqëria civile.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! A keni ndonjë diskutim tjeter? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim! Kush është “për”?... kundër?... Me shumicë votash (4 vota pro), aprovohet pika e katërt.

5. Shqyrtimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 8/2013, të datës 2.4.2013, për konstituimin e të drejtës së servitutit sendor në pronësinë komunale.

Afrim Oruqi: Sipas ligjit, po marrim vendim për ndryshim dhe për vendim të ri për drejtkalim të drejtë servituti. Vendimi i vjetër do të shfuqizohet. Bëhet fjalë për zonë kadastrale – Rahovec, konkretisht për pronë komunale, ku aktualisht është shtëpia e shëndetit dhe pas tre viteve aty ka filluar të ndërtohet çerdhja nga Ministria e Arsimit. Në vitin 2017, ka pasur një vendim, banorët kanë pasur të drejtë kalimi në këtë parcelë pa rrugë. Për shkak të rimodelimit të zonës, është dashur që vendimin e vjetër ta shfuqizojmë komplet dhe ta marrim vendimin e ri, sepse rruga do të sigurohet nëpër dy parcela. Janë parcela të përmendura me sipërfaqe, kanë gjatësi dhe gjëresi që të dalin banorët e pronave që kufizohen me këto dy parcela të komunës dhe që nuk kanë dalje publike.

Burim Krasniqi: Kërkoj që në seancë kur të vijmë ta kemi edhe vendimin e 2017-tës dhe të dimë se cili vendim shfuqizohet. Jo ta shfuqizojmë një vendim të cilin nuk e kemi para vetes.

Defrim Kafexhiu: Nëse ka mundësi drejtori t'i tregojë me emër pronarët e parcelave në fjalë, që po u mundësohet shfrytëzimi i pronës publike për kalim?

Afrim Oruqi: Do të kujdesemi që kuvendarit Burim Krasniqi t'ia sigurojmë edhe vendimin e vjetër që po e shfuqizojmë. Në pyetjen e kuvendarit Defrim Kafexhiu: përrreth kësaj parcele të komunës janë prona të pronarëve me mbiemër Hamza dhe në vendimin e vjetër që u është dhënë e drejta këtyre banorëve,

përmendet emri i z. Hysen Mahmut Hamza. Janë disa parcela dhe në vendimin e ri nuk do ta përmendim emrin e kërkuesit, sepse, sipas ligjit, në rast se këto parcela parcelizohen, numrat arkivohen – krijohen numra të ri dhe dikujt në të ardhmen mund që t'i pamundësohet të kalojë në të njëjtën rrugë.

Burim Krasniqi: E kam lexuar vendimin, po ndonjëherë detajet të ikin. Meqenëse llogaritet të jetë më shumë se një parcelë që do të kyçen në këtë rrugë në të ardhmen dhe meqenëse është pronë komunale dhe nuk ka kosto të shpenzimeve në kuptimin e shpronësimit, mundësish gjerësia të jetë 5m dhe jo 4m. Në 4 metra nuk është mundësia e përballëkalimit për dy vetura.

Afrim Oruqi: Është e arsyeshme kjo, mirëpo ne e kemi incizuar terrenin me gjedhetë dhe objekti i shtëpisë së shëndetit deri në kufi të pronës komunale nuk na jep mundësinë të manovrojmë më shumë. Është rrugë pa dalje dhe për vetëm disa prona. Mendojmë që edhe vendimi i vjetër është me gjerësi prej 4m. Do të vazhdojmë njëjtë që mos ta rrezikojmë funksionalitetin e shtëpisë së shëndetit në të ardhmen.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! A keni ndonjë diskutim tjetër? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim! Kush është “për”... kundër?... Me shumicë votash, (4 vota pro) aprovohet pika pestë.

6. Shqyrtimi i vendimit për miratimin e të drejtës së kalimit në parcelën publike komunale me nr. 71510032-00069-0, Z.K. Zoqisht:

Afrim Oruqi: Të nderuar anëtarë të KPF-së, para jush e keni vendimin e propozuar nga kryetari i Komunës, për miratimin e të drejtës së kalimit në parcelën publike komunale me nr. 00069-0 – Z.K. Zoqisht. Bëhet fjalë saktësisht te parcela ku është Shkolla Fillore e Mesme e Ulët “Haki Stërmilli”. Është parcelë me sipërfaqe të përgjithshme prej 94 ari e 89m. Pronat përreth kësaj parcele, që na dërgojnë në drejtim të rrugës kryesore Rahovec-Suharekë, janë pa dalje. Aty në terren, prej paraluftës, janë duke e shfrytëzuar një korridor nëpër këtë parcelë të shkollës. Me nënshkrime të banorëve të këtij komuniteti, ka kërkesë dhe gjithashtu, në konsultim me drejtorin e shkollës, drejtorin e DKA-së, kryesinë e fshatit Zoqisht, e kemi marrë pëlqimin e tyre, që t'u japim drejtikalimin pa e tjetërsuar pronën dhe duke mos e rrezikuar veprimtarinë e shkollës. Me gjerësi të përgjithshme prej 462m², në gjatësi prej 94,89m, në gjatësi dhe gjerësi prej 5m.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! A keni ndonjë diskutim tjetër? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim. Kush është “për”... kundër?... abstenim?... Me shumicë votash (4vota pro), aprovohet pika e gjashtë.

7. Të ndryshme:

Burim Krasniqi: Në seancën e kaluar të KPF-së, i kam pasur dy kërkesa. Sekretaria a i ka përcjellë kërkesat e mia në ekzekutiv? Nëse po, i kërkoj ekzekutivit të përgjigjet para seancës së Kuvendit.

Defrim Kafexhiu: Sikur në seancën e kaluar dhe në mbledhjen e kaluar të KPF-së, ju lus juve si kryesues i Kuvendit, nën kryetarin e Komunës, që, në konsultim me kryetarin, gjatë përpilimit të rendit të ditës për seancën e rregullt, pikën e fundit të rendit të ditës ta vendosni si pikë të dytë.

Burim Krasniqi: Kërkoj mirëkuptimin nga ju kryesues, që në seancën e rregullt ta kemi një informatë për secilin asambleist se nga sa paga dhe mëditje i marrin? Të gjitha informatat mbi të hyrat prej buxhetit të shtetit.

Kryesuesi: Faleminderit Burim Krasniqi! Të nderuar anëtarë, dua t'ju informoj që në seancën e rregullt do ta kemi edhe një pikë shtesë.

Skender Hamza: Pjetjet që i ka bërë Burimi, ne si sekretari ia kemi dërguar ekzekutivit. I presim përgjigjet nga ekzekutivi dhe më pas t'ju dërgojmë juve.

Nën kryetari: Faleminderit, kryesues! Në aspektin ligjor, nuk e di sa lejohet kërkesa e Burimit. Në këtë rast, dhënia e informatave rreth pagave. Nuk e di, e trajton zyra ligjore. Te kërkesa e asambleistikit Defrim Kafexhiu: te renditja e pikave, ka qenë një vendim me votë në Kuvend dhe besoj që në të njëjtën mënyrë duhet të veprojmë përsëri. Do të konsultohem me kryetarin dhe do të shikojmë. Në fund, në bazë të kërkesës së kryesisë të fshatit Drenoc, kemi kërkesë prej tyre për shpallje të shtëpisë-muze të dy heronjve,

Bedrush dhe Feim Gashi. Meqenëse tani jemi në vigjilje të përvjetori të heroit të Kosovës, Feim Gashi, më 27 maj. Për momentin, ajo shtëpi figuron në emër të Ramadan Qazim Morinës, mirëpo, në bazë të informatave që kemi, aktgjykimi është përfundimtar dhe pritet transaksi i juridik në Drejtoreni për Kadastër. Në momentin që do të përfundojë kjo, besoj që materialin brenda 2-3 dite do ta keni ju si kuvendarë.

Burim Krasniqi: Sa i përket çështjes së pagave, realisht shpenzimet që i bën komuna i kemi edhe në faqen ueb të Komunës. Kërkoj që zyrtarisht ta kemi për secilin, mos t'i mbetet "hatri" askujt. Nuk besoj që ka pengesë ligjore përfundimtar se është publike. E dyta, nëse do të ketë vonesa në procedurën e pronës te rasti i dëshmorit, besoj që ne mund ta marrim një vendim lirshëm këtu dhe ta obligojmë ekzekutivin që t'i ndjekë procedurat ligjore të zbatimit të plotë të vendimit në kuptimin ligjor, të shpalljes së shtëpisë-muze përfundimtar e kombit.

Nënkyryetari: Nëse ka bazë ligjore, te pagat unë jam dakord. Po ju tregoj që paga e secilit nënkyryetar Komune që ka numër të njëjtë të popullsisë është 987€ e imja me përvojë të punës 18 vjet.

Kryesuesi: Faleminderit, nënkyryetar! Pajtohem plotësisht. Besoj që do t'i keni të gjitha informatat e nevojshme. Me këto diskutime po e përfundojmë mbledhjen e pestë të KPF-së. Shihemi në mbledhjen e rregullt të kuvendit.

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

K R Y E S U E S I

Arbër Zenuni

